



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA | REPUBLIC OF KOSOVO
AGJENCIA PËR PARANDALIMIN E KORRUPSIONIT
AGENCIJA ZA SPREČAVANJE KORUPCIJE
AGENCY FOR PREVENTION OF CORRUPTION

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
AGJENCIA PËR PARANDALIMIN E KORRUPSIONIT
AGENCIJA ZA SPREČAVANJE KORUPCIJE
AGENCY FOR PREVENTION OF CORRUPTION

01
Dep. _____
Nra. Fag. _____
Er. Str. _____
Nr. Page. _____

703/24
16.05.24
PRISHTINA
LABORATORIUS ETHICUS
SINE CONVIVENTIA

Në bazë të Nenit 12, paragrafi 1, nën paragrafi 9, Nenit 23 të Ligjit Nr.08/I-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korruptionit, (*Gazeta Zyrtare nr. 19, datë 21.07.2022*) si dhe në kuptim të Ligjit Nr. 08/L-108 për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe të Dhuratave (*Gazeta Zyrtare Nr. 22/10 gusht 2022*), Drejtori i Agjencisë për Parandalimin e Korruptionit, me datë 16 maj 2024, nxjerr:

**RREGULLORE Nr. 06/2024 PËR SHQIPTIMIN E GJOBAVE SI DHE MASAVE TJERA
SANKSIONUESE NGA AGJENCIA PËR PARANDALIMIN E KORRUPSIONIT**

Neni 1
Qëllimi

Kjo Rregullore ka për qëllim përcaktimin e rregullave të brendshme në Agjencinë për Parandalimin e Korruptionit (tani e tutje: Agjencia) për procedurën e shqiptimit të gjobave dhe masave tjera sanksionuese nga Agjencia, për qëllime të zbatimit të Ligjit Nr. 08/L-108 për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe të Dhuratave.

Neni 2
Fushëveprimi

Kjo Rregullore zbatohet nga njësitetë përgjegjëse në Agjenci si: Divizioni për Kontroll dhe Verifikimin e Pasurisë, Divizioni për Inspektimin dhe Auditimin e Dhuratave, Divizioni për E-shërbime dhe Sisteme, Zyrtari për të hyra, Komisioni për shqyrtimin e Ankesave.

Neni 3
Përkufizimet

Shprehjet dhe termet e përdorura në këtë Rregullore, kanë kuptimin e njëjtë me përkufizimet e dhëna në Ligjin Nr.08/I-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korruptionit dhe Ligjin Nr. 08/L-108 për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe të Dhuratave.

Neni 4
Masat dhe sanksionet kundërvajtëse

- Masat dhe sanksionet kundërvajtëse të cilat i shqipton Agjencia ndaj subjekteve deklaruese, zyrtarëve përgjegjës të institucioneve si dhe personave zyrtarë në rastet e shkeljes së dispozitave të Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe të Dhuratave janë:
 - Gjoba;
 - Qortim jo-publik;
 - Qortim publik.



2. Masat dhe sanksionet kundërvajtëse Agjencia i shqipton përmes nxjerrjes së vendimit.

Neni 5
Sanksioni kundërvajtës me gjobë

1. Gjoba si masë kundërvajtëse, sipas kësaj Rregulloreje do të shqiptohet nga Agjencia për subjektet deklaruese, zyrtarët kontaktues, zyrtarët përgjegjës të institucioneve si dhe personat zyrtarë, në rast të shkeljes së dispozitave të Ligjit Nr. 08/L-108 për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe të Dhuratave.
2. Subjekti deklarues për vonesë të deklarimit të pasurisë do të ndëshkohet me gjobë në shkallë prej tridhetë për qind (30%) të pagës mujore neto nga funksioni primar i subjektit deklarues, por në asnjë rast kjo shumë nuk do të kalojë pragun prej pesëqind Euro (500€).
3. Zyrtari kontaktues në rast se nuk zbaton detyrat sipas ligjit, do të ndëshkohet me gjobë në shumën deri në dhjetë për qind (10%) të pagës mujore neto të pikës së kontaktit, por në asnjë rast kjo shumë nuk do të kalojë pragun prej pesëqind Euro (500€).
4. Zyrtari kryesor administrativ ose pozita ekuivalente, në rast se nuk cakton me vendim zyrtarin kontaktues, do të ndëshkohet me gjobë ose nuk inicion procedurën disiplinore ndaj zyrtarit kontaktues si në paragrafin 3 të këtij Neni, do të ndëshkohet me gjobë në shumën deri në dhjetë për qind (10%) të pagës mujore neto të zyrtarit kryesor administrativ ose pozitës ekuivalente me të, por në asnjë rast kjo shumë nuk do të kalojë pragun prej pesëqind Euro (500€).
5. Zyrtari kryesor administrativ ose pozita ekuivalente, në rast se nuk përbush kërkesat e Agjencisë për dhënie të informacioneve apo dokumenteve në lidhje me deklarim të pasurisë së subjekteve deklaruese do të ndëshkohet me gjobë në shumën deri në njëzet për qind (20%) të pagës mujore neto të zyrtarit kryesor administrativ ose pozitës ekuivalente me të, por në asnjë rast kjo shumë nuk do të kalojë pragun prej pesëqind Euro (500€).
6. Personi zyrtar i cili nuk njofton institucionin e tij për pranimin e dhuratës, do të ndëshkohet me gjobë deri në dhjetë për qind (10%) të pagës mujore neto të tij, por në asnjë rast kjo shumë nuk duhet të kalojë pragun prej pesëqind Euro (500€).
7. Personi zyrtar që nuk dorëzon dhuratën për ta ekspozuar në këndin e dhuratave, do të ndëshkohet me gjobë deri në dhjetë për qind (10%) të pagës mujore neto të tij, por në asnjë rast kjo shumë nuk duhet të kalojë pragun prej pesëqind Euro (500€).
8. Zyrtari kontaktues i cili nuk përditëson regjistrin e dhuratave apo dështon në njoftimin e Agjencisë për regjistrin e dhuratave, do të ndëshkohet me gjobë deri në dhjetë për qind (10%) të pagës mujore neto të tij, por në asnjë rast kjo shumë nuk duhet të kalojë pragun prej pesëqind Euro (500€).



Neni 6
Qortimi publik dhe jo publik

1. Përveç sanksionimit kundërvajtës me gjobë, Agjencia shqipton edhe masa tjera sanksionuese qortim publik dhe jo publik, në rastet e përcaktuara sipas Nenit 5 të kësaj Rregulloreje.
2. Qortimi publik dhe jo publik si masa kundërvajtëse shqiptohen në rastet kur ekzistojnë rrethana të arsyeshme apo bindëse sipas një analize dhe vlerësimi paraprak nga ana e njësive përkatëse, për subjektet deklaruese, zyrtarët kontaktues, zyrtarët përgjegjës të institucioneve si dhe personat zyrtarë, të cilat mund të merren për bazë si rrethana për shqiptimin e masave.
3. Rrethanat të cilat mund të merren për bazë nga Agjencia për përjashtim nga shqiptimi i gjobës dhe zbatimi i qortimit publik dhe jo publik, janë por pa u kufizuar vetëm në rastet si më poshtë:
 - 3.1. për subjektet deklaruese rrethanat në të cilën është kryer shkelja, si në situatat e përcaktuara në Nenin 8, paragrafi 4 i kësaj Rregulloreje, pa u kufizuar vetëm në këto raste;
 - 3.2. për subjektet deklaruese rrethanat në të cilën është kryer shkelja, kur subjekti deklarues nuk realizon të hyra nga funksioni deklarues/primar (si për shembull funksion ky i kryer “pro bono” nga subjekti deklarues, dhe nuk pranon ndonjë pagë tjetër primare nga institucionet publike);
 - 3.2. për zyrtarët kontaktues nëse shkelja ka ndodhur për herë të parë apo për arsy objektive, jashtë kontrollit të tyre.

Neni 7
Përcaktimi i gjobës për subjektet deklaruese

1. Agjencia shqipton gjobë ndaj subjekteve deklaruese në rast të vonesës së deklarimit të pasurisë sipas afateve të përcaktuara me Ligjin për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe të Dhuratave si në vijim:
 - 1.1. për subjektet e reja, pasi të ketë kaluar afati 30 ditë pas marrjes së detyrës.
 - 1.2. për subjektet ekzistuese, pasi të ketë kaluar afati për deklarim të rregullt vjetor 1 deri më 31 mars të secilit vit.
 - 1.3. për subjektet që përfundojnë mandatin, shkarkohen, ose pensionohen, pasi të ketë kaluar afati 30 ditë pas përfundimit të mandatit apo detyrës.
 - 1.4. për subjektet deklaruese/ushtrues/zëvendësues të detyrës, tridhjetë (30) ditë nga dita kur është tejkaluar periudha tre (3) mujore e ushtrimit/zëvendësimit të detyrës.



Neni 8
Kushtet për shqiptimin e gjobës ndaj subjekteve deklaruese

1. Divizioni për Kontrollin dhe Verifikimin e Pasurisë në bashkëpunim me Divisionin për E-Shërbime dhe Sisteme, do të verifikojë vonesën e paraqitjes së deklaratës së pasurisë.
2. Sipas të gjeturave nga procesi i verifikimit, Divizioni për Kontrollin dhe Verifikimin e Pasurisë do të kontaktojë zyrtarin kontaktues të institucionit për të konfirmuar të dhënrat e regjistrimit të saktë dhe në kohë.
3. Divizioni për Kontrollin dhe Verifikimin e Pasurisë do të kontaktojë subjektin deklarues për të dhënë një sqarim lidhur me vonesën, si dhe dëshmi për mosveprimin me kohë.
4. Në rastet kur subjekti deklarues arrin të dëshmojë me prova të arsyeshme vonesën e tij për deklarim të pasurisë, gjoba nuk shqiptohet në rast kur konstatahet se:
 - 4.1. subjekti deklarues së paku në pesë (5) ditët e fundit para përfundimit të afatit për deklarim të pasurisë ka qenë i sëmurrë/i shtrirë, apo anëtari i tij/saj i ngushtë i familjes sipas Ligjit Nr. 08/L-108, dhe këtë arrin ta dëshmojë me raport të mjekut për pushim mjekësor;
 - 4.2. subjekti deklarues së paku në pesë (5) ditët e fundit para përfundimit të afatit për deklarim të pasurisë, ka qenë në udhëtim zyrtar jashtë vendit, dhe në pamundësi të qasjes në sistem si dhe të sigurimit të informacioneve zyrtare për qëllime të deklarimit të pasurisë, nuk ka mundur ta bëjë deklarimin e pasurisë brenda afatit, dhe këtë arrin ta dëshmojë me një raport nga punëdhënësi;
 - 4.3. kur në ditën e fundit të afatit për deklarim të pasurisë, sistemi elektronik i deklarimit të pasurisë nuk ka funksionuar ose nuk është përcjellë njoftimi për deklarim të pasurisë, e cila konfirmohet nga Agjencia si dhe nga/ose Agjencia për Shoqërinë e Informacionit (ASHI).
 - 4.4. kur zyrtari kontaktues ka regjistruar gabimisht numrin personal ose e-mail adresën e subjektit deklarues, dhe deri në ditën e fundit të afatit të deklarimit të pasurisë nuk ka pranuar kredencialet për qasje në sistem, e cila dëshmohet nga zyrtari kontaktues i institucionit.
 - 4.5. kur subjekti deklarues për periudhën e deklarimit të pasurisë, është në mbajtje nga organet e drejtësisë dhe nuk ka mundësi të qasjes në sistem.



Neni 9

Procedura për shqiptimin e gjobave ndaj subjekteve deklaruese

1. Pas verifikimit dhe vërtetimit se nuk ka arsyesh dhe prova bindëse të cilat arsyetojnë vonesën e deklarimit të pasurisë nga subjekti deklarues, Divizioni për Kontrollin dhe Verifikimin e Pasurisë do të kontaktojë Ministrinë e Financave, përkatësisht Thesarin, punëdhënësin apo institucionet përkatëse, për të marrë informacion mbi pagën mujore të subjektit deklarues.
2. Paga mujore bazë neto e fundit të pranuar nga funksioni primar deklarues, në periudhën kur është bërë deklarimi i pasurisë, varësish llojitet të deklarimit, të rregullt, me marrje të detyrës apo me përfundim të mandatit, merret si bazë e llogaritjes së gjobës.
3. Në bazë të informacioneve të siguruara sipas paragrafit 1 të këtij Neni, mbi pagën mujore të subjektit deklarues, Divizioni për Kontrollin dhe Verifikimin e Pasurisë përmes një raporti me shkrim i cili përmban kronologjinë e ndërmarrjes së veprimeve, propozon vlerën e gjobës të kalkuluar sipas Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe të Dhuratave.
4. Propozimi për gjobë dërgohet te Drejtori i Departamentit për Kontrollin e Pasurisë dhe Dhuratave i cili aprovon reportin dhe përgatit draft vendimin për gjobë i cili dërgohet për miratim te Drejtori i Agjencisë.
5. Drejtori i Agjencisë me vendim miraton shqiptimin e gjobës.
6. Vendimi për gjobë do të dërgohet te pala përmes postës së rregullt fizike, dhe/ose elektronike, në adresën e pranuar nga punëdhënësi/zyrtari kontaktues i institucionit.
7. Varësish formës së dërgimit të vendimit të Agjencisë te pala, si bazë e fillimit të afatit për ekzekutimin e Vendimit të Agjencisë merret:
 - 7.1. në rast të vendimit të dërguar në formë fizike, data e nënshkrimit të kopjes së pranuar të vendimit;
 - 7.2. në rast të vendimit të dërguar përmes postës së rregullt, data e nënshkrimit të dëshmisë nga posta;
 - 7.3. në rast të vendimit të dërguar përmes postës elektronike/e-mail-it, data e dërgimit.



Neni 10
Përcaktimi i gjobave për zyrtarët përgjegjës të institacioneve

1. Agjencia shqipton gjoba ndaj zyrtarëve përgjegjës të institacioneve, zyrtarëve kontaktues dhe zyrtarëve kryesorë administrativë, në rast të dështimit të kryerjes së detyrave sipas Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe të Dhuratave, të përcaktuara si në Nenin 5 të kësaj Rregulloreje, nëse:
 - 1.1. zyrtari kontaktues nuk i ka njoftuar me kohë subjektet e reja me marrje të detyrës për deklarimin e pasurisë brenda afatit 30 ditë pas marrjes së detyrës, dhe si rezultat vie deri te deklarimi i pasurisë me vonesë nga subjekti deklarues;
 - 1.2. zyrtari kontaktues nuk ka njoftuar dhe nuk ka përcjellë me kohë listën e subjekteve deklaruese me ndryshime në Agjencji;
 - 1.3. zyrtari kontaktues nuk i regjistrion dhuratat e pranuara nga personat zyrtar në regjistrin e institucionit;
 - 1.4. zyrtari kontaktues nuk mirëmban regjistrin institucional të dhuratave dhe nuk ia mundëson Agjencisë qasjen;
 - 1.5. siguron se ka njoftuar titullarin e institucionit për sigurimin e këndit për ekspozimin e dhuratave të pranuara nga personat zyrtarë të institucionit.
 - 1.6. zyrtari kryesor administrativ ose pozita ekuivalente nuk cakton me vendim të shkruar zyrtarin kontaktues ose nuk inicion procedurën disiplinore pas njoftimit të Agjencisë se zyrtari kontaktues ka dështuar në përmbushjen e detyrave të përcaktuara si në Nenin 10 të kësaj Rregulloreje;
 - 1.7. zyrtari kryesor administrativ ose pozita ekuivalente nuk përmbush kërkesat e Agjencisë për dhënie të informacioneve apo dokumenteve në lidhje me deklarimin e pasurisë dhe dhuratave të subjekteve deklaruese dhe personave zyrtarë.

Neni 11
Kushtet për shqiptimin e gjobave për zyrtarët përgjegjës të institacioneve

1. Departamenti për Kontroll të Pasurisë dhe Dhuratave në bashkëpunim dhe koordinim me Divisionin për E-Shërbime dhe Sisteme, do të shqyrtojnë dhe vlerësojnë çdo fakt dhe rrëthanë të dështimit të kryerjes së detyrave nga zyrtarët përgjegjës të institacioneve dhe personat zyrtarë, sipas ligjit dhe kësaj rregulloreje.



2. Departamenti për Kontroll të Pasurisë dhe Dhuratave do të kontaktojë zyrtarin kontaktues përkatës, zyrtarin kryesor administrativ dhe personin zyrtar për të dhënë një sqarim me shkrim lidhur me dështimin e përbushjes së detyrave të tyre të përcaktuara me ligj si edhe me këtë Rregullore.
3. Gjobat dhe masat tjera sankzionuese ndaj zyrtarit kontaktues, zyrtarit kryesor administrativ dhe personit zyrtar propozohen nga Departamenti për Kontroll të Pasurisë dhe Dhuratave, varësisht të gjeturave si dhe fakteve të mbledhura nga procesi i vlerësimit dhe verifikimit, kur:
 - 3.1. ka arsye dhe prova bindëse se detyrat e zyrtarit kontaktues nuk janë kryer me kohë sipas Ligjit dhe kësaj Rregulloreje;
 - 3.2. ka arsye dhe prova bindëse se zyrtarët kryesorë administrativë nuk kanë kryer detyrat e tyre dhe nuk i kanë ndërmarrë veprimet e nevojshme të përcaktuara me ligj dhe me këtë Rregullore.

Neni 12
Përcaktimi i gjobës për personat zyrtarë

Agjencia shqipton gjobë ndaj personave zyrtarë në rastet kur personi zyrtar nuk njofton institucionin e tij për pranimin e dhuratës dhe nuk dorëzon dhuratën për ta eksposuar në këndin e dhuratave të përcaktuara me Ligjin si dhe në Nenin 5 të kësaj Rregulloreje.

Neni 13
Procedura për shqiptimin e gjobave ndaj zyrtarëve përgjegjës të institacioneve dhe personave zyrtarë

Pas verifikimit dhe vërtetimit të të gjitha rr Ethanave dhe fakteve të vlerësuara gjatë fazës së shqyrtimit në rastet e përcaktuara si në Nenin 10 dhe 12 të kësaj Rregulloreje, Agjencia do të zbatojë masat dhe sankzionet kundërvajtëse me gjobë ndaj zyrtarëve kontaktues, zyrtarëve kryesorë administrativë dhe personave zyrtarë në shkallën e përcaktuar sipas ligjit dhe kësaj Rregulloreje.

Neni 14
Mënyra dhe afati i pagesës së gjobës

1. Gjobat paguhen në llogarinë e Agjencisë dhe transferohen në Buxhetin e Kosovës.
2. Zyrtari për të hyra në Agjenci, plotëson formularin e gjobës dhe e regjistron në sistemin adekuat.



3. Nëse pala ndaj të cilës është shqiptuar gjoba, paguan gjobën brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga data e pranimit të vendimit për gjobë, do të paguajë vetëm gjysmën (50%) e gjobës së shqiptuar për shkeljen e bërë.
4. Nëse pala e gjobitur nuk e paguan gjobën në afatin e përcaktuar sipas paragrafit 3 të këtij Neni, gjoba do të ekzekutohet përmes institucionit përkatës që administron me listën e pagave.
5. Nëse pala e gjobitur nuk është në listën e pagave ose nuk është i/e punësuar në institucionin përkatës, gjoba do të ekzekutohet përmes procedurës përbartimore, e cila do të verifikohet nga zyrtari i të hyrave në Agjenci.
6. Parashtrimi i ankesës në Agjenci nga pala e pakënaqur për shqiptimin e gjobës, nuk ndalon ekzekutimin e Vendimit të Agjencisë.

Neni 15
Procedura e ankesës

1. Pala e pakënaqur me Vendimin për shqiptimin e gjobës apo masave tjera sankzionuese nga Agjencia, mund të parashtrojë ankesë pranë Komisionit të Ankesave në Agjenci, në afatin prej tetë (8) ditësh nga data e pranimit të Vendimit të shqiptuar për gjobë dhe masave tjera sankzionuese.
2. Komisioni i Ankesave i emëruar me Vendim nga Drejtori i Agjencisë, do të shqyrtojë dhe do të vundos lidhur me ankesat e parashtruara nga palët e pakënaqura ndaj Vendimeve të Agjencisë për shqiptimin e gjobave dhe masave tjera sankzionuese.
3. Komisioni për Shqyrtimin e Ankesave të parashtruara nga palët e pakënaqura përbëhet prej së paku prej tre (3) anëtarëve, me mandat tre (3) vjeçar.
4. Komisioni i Ankesave mund të aprovoj plotësisht apo pjesërisht, ose ta refuzoj si të pabazuar ankesën, dhe për Vendimin do të njoftohen palët në procedurë.
5. Në rast të aprovimit apo aprovimit të pjesshëm të ankesës, Komisioni i Ankesave nxjerrë vendimin për plotësim/ndryshim të gjobës.
6. Departamenti për Kontrollin e Pasurisë dhe Dhuratave, do të caktojë nga një zyrtar brenda Divizioneve përkatëse, të shërbejë si Sekretariat i Komisionit të Ankesave.



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA | REPUBLIC OF KOSOVO
AGJENCIA PËR PARANDALIMIN E KORRUPSIONIT
AGENCIJA ZA SPREČAVANJE KORUPCIJE
AGENCY FOR PREVENTION OF CORRUPTION



Neni 16

Rishikimi

Kjo rregullore mund të rishikohet në çdo kohë, varësisht nevojave që mund të paraqiten për ndryshim/plotësimin e saj.

Neni 17
Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Ylli BULESHKAI
Agjencia për Parandalimin e Korruptionit